

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

URDHRI I FARMACISTËVE

KËSHILLI KOMBËTAR

Nr. 3/8 Prot.

Tiranë, më 26/01/2024

VENDIM

Nr. 8, datë 26.01.2024

Për miratimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrim në provimin e shtetit

Në zbatim të nenit 11, pika 4 të Ligjit Nr. 9150 datë 30.10.2003, “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), nenit 25 të Statutit të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, nenit 12 të ligjit Nr. 10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, nenit 13 dhe 14 të “Rregullores për funksionimin e Komisionit të Provimit të shtetit dhe procedurat e zhvillimit të provimit të shtetit”, të miratuar me Urdhrin Nr. 365, datë 28.12.2020, të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në mbledhjen e datës 26.01.2024 Këshilli Kombëtar;

Vendosi:

1. Të miratojë Formularin e aplikimi për regjistrim në provimin e shtetit, sipas lidhjes Nr. 1, bashkëlidhur.
2. Të miratojë listën e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrim për provimin e shteti, për kandidatët farmacistë si mëposhtë:
 - Fotokopje e kartës së identitetit;
 - Fotokopje e noterizuar e diplomës/diplomave të programit të studimeve për profesionin/profilin respektiv; (vërtetimin për njohjen dhe njësimin e diplomës në rastet kur studimet janë përfunduar jashtë shtetit);
 - Dokumentacionin e lëshuar nga institucioni përgjegjës për arkivat që provon lëshimin e diplomës apo dokumentit të barasvlefshëm me të, të fituar nga institucioni i arsimit të mbyllur, ose fotokopje të noterizuar të tij;



- Dokumentin që vërteton vlefshmërinë e diplomës/diplomave të lëshuar;
 - Dëshminë e pjesëmarrjes në praktikën profesionale, të lëshuar Urdhri i Farmacistëve.
3. Kur kandidati është përsëritës, aplikimi do të kryhet vetëm online në portalin e-Albania.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT

Defrim GOMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I FARMACISTËVE
KËSHILLI KOMBËTAR

Tiranë më ____/____/____

Formular aplikimi për regjistrim në provimin e shtetit

Emri, Atësia, Mbiemri _____

Vendbanimi _____

Universiteti _____

Numri i diplomës _____

Data e diplomimit _____

Numri i dosjes praktikës profesionale _____

Numri i celularit _____

Adresa e-mail _____

Regjistrohem për herë të _____

(Shënim: Aplikanti mban përgjegjësi për cdo të dhënë gabim apo të pasaktë)

Dokumentacioni i kërkuar:

1. Fotokopje e kartës së identitetit;
2. Fotokopje e noterizuar e diplomës/diplomave të programit të studimeve për profesionin/profilin respektiv; (vërtetimin për njohjen dhe njësimin e diplomës në rastet kur studimet janë përfunduar jashtë shtetit);
3. Dokumentacionin e lëshuar nga institucioni përgjegjës për arkivat që provon lëshimin e diplomës apo dokumentit të barasvlefshëm me të, të fituar nga institucioni i arsimit të mbyllur, ose fotokopje të noterizuar të tij;
4. Dokumentin që vërteton vlefshmërinë e diplomës/diplomave të lëshuar;
5. Dëshminë e pjesëmarrjes në praktikën profesionale, të lëshuar Urdhri i Farmacistëve.

Shënim: Kur kandidati është përsëritës, aplikimi do të kryhet vetëm online në portalin e-Albania.

Marrësi në dorëzim**Aplikanti**